



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Planuar / Doretuar Prijmenjeno/Prodato Received / Delivery	17.05.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojt e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHCK	2880/2022		113



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.327/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtar dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.327/2022 të datës 05.04.2022 e parashtruar nga ankuesi me adres banimi në

kundër organit të punësimit Agjencia Pyjore e Kosovës, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 17.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar me ankesën me numër A.nr.327/2022 të datës 05.04.2022 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi sipas Akt emërimit me numër ZP-83/2012 të datës 31.01.2012 është i sistemuar në vendin e punës “Zyrtar për Çështje Ekonomike” në Drejtorinë Koordinuese të Agjencisë Pyjore të Kosovës në Gjilan, i cili me datë 05.04.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 1852/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendim ankimor për kompensimin e pagës në mënyrë retroaktive nga data 18.03.2020 gjer më datën 03.02.2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 13.04.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Agjencinë Pyjore të Kosovës. Ndërsa me datë 27.04.2022 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/12.



Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 05.04.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi Ref.KE-38/22 i datës 02.02.2022 i Kryeshefit Ekzekutiv; Vendimi A.nr.1186/2021 i datës 14.01.2022 e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Shkresa e datës 28.05.2021; e-mail i datave 01.03.2022, 10.02.2022; Formulari i të dhënave për listën e pagave i datës 10.02.2022; Lista e pagave për muajin mars 2022; Akt emërimi i ankuesit i datës 31.01.2012 si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruar nga ankuesi dhe organi i punësimit, konstaton se është plotësuar kërkesa ligjore për përfundim të procedimit administrativ e filluar me ankesën me numër A.nr.327/2022 të datës 05.04.2022 e parashtruar nga ankuesi *sepse:*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit të shkresave të lëndës, ka konstatuar se me Vendimin me numër A.Nr.1186/2021 të datës 14.01.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka aprovuar si të bazuar ankesën e ankuesit me numër A.Nr.150/2022 të datës 27.05.2020, ka shfuqizuar Vendimin me numër Ref.SBNJD-120/20 i datës 28.04.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Agjencisë Pyjore të Kosovës dhe Vendimin me numër Ref.SBNJ-83/2020 i datës 13.03.2020 i protokolluar me datë 18.03.2020 i Komisionit Disiplinor të Agjencisë Pyjore të Kosovës ndërsa në dispozitivin e tretë të vendimit është cekur se ankuesi kthehet në vendin e punës sipas Akt Emërimit të datës 31.01.2012 në pozitën “Zyrat për Çështje Ekonomike” në Drejtorinë Koordinuese të Agjencisë Pyjore të Kosovës në Gjilan me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e tij nga marrëdhënia e punës dhe po ashtu decidivisht me këtë vendim iu është njohur edhe kompensimi i të gjithave pagave nga data e ndërprerjes së marrëdhënies së punës deri në zbatimin e vendimit, kurse me datë 05.04.2022 ankuesi ka parashtruar ankesë me numër protokollit 1852/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendim ankimor për kompensimin e pagës në mënyrë retroaktive nga data 18.03.2020 gjer më datën 03.02.2022 dhe kërkon nga Këshilli që ti aprovohet ankesa për kompensim retroaktiv nga data 18.03.2020 gjer më datën 03.02.2022 si dhe të detyrohet organi i punësimit që t’ia paguaj kamatën ligjore me të gjithë kompensimin e pagave retroaktiv për periudhën 18.03.2020 gjer më datën 03.02.2022 nëse nuk zbatohet vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për herë të dytë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në këto rrethana, ka konstatuar se meqenëse ankuesit me Vendimin me numër A.Nr.1186/2021 të datës 14.01.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës iu është njohur e drejta e kompensimit të të gjithave pagave nga data e ndërprerjes së marrëdhënies së punës dhe se organi i punësimit respektivisht Agjencia Pyjore e Kosovës ka sjellë dëshmitë “Formulari i të dhënave për listën e pagave” si dhe ka bashkangjitur dëshmi listën e pagave për muajin mars të vitit 2022 vërtetohet se ankuesi është kompensuar për muajin shkurt të vitit 2022 me pagën e muajit mars të vitit 2022, atëherë konsideron që objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit për kompensim retroaktiv të pagës




nga data 18.03.2020 gjer më datën 03.02.2022 është bërë i pamundur apo i kotë sepse me këtë rast nuk ka objekt të shqyrtimit, kështu në pajtim me dispozitat e nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”*, andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka bërë përfundimin e procedimit administrativ të iniciuar me ankesën me numër A.nr.327/2022 të datës 05.04.2022 të parashtruar nga ankuesi po ashtu Kolegji e rikujton ankuesin se për mos pagesën e pagës sipas Vendimit me numër A.Nr.1186/2021 të datës 14.01.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ankuesi ka të drejtë që ti ndër marr veprimet në pajtim me nenin 23 paragrafin 7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që ka përcaktuar se: *“Brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e kalimit të afatit për zbatim të vendimit të Këshillit, pala mund të fillojë procedurën e përmbartimit të vendimit të Këshillit në gjykatën kompetente, në pajtim me dispozitat e ligjit për procedurën përmbartimore”*.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.327/2022

Valentina Kaçandolli Bekteshi



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI



Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë Pyjore të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.